



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 02.02.2021, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendlit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021

- I. Miratohet përfshirjen e votuesve të aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve jashtë vendlit, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021 .
- II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i SKQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 02.02.2021

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Datë	02.02.2021	Referencë	
Për	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve		
Përmes	Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së		
Nga	Departamenti i Operacioneve Zgjedhore		
Tema	Rekomandim: Për përfshirjen e votuesve të aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendlindit,		

Sipas Planit Operacional për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, Lista e votuesve certifikohet sot, me datën 02.02.2021. Po ashtu, sot fillon edhe Periudha e Votimit për aplikuesit që janë regjistruar suksesshëm për të votuar përmes postës.

Aktualisht, sipas raporteve që kemi për thirrjet e realizuara, janë realizuar 83,122 thirrje telefonike, ku nga këta kanë konfirmuar të dhënat 65,400 aplikues. Ndërsa 17,436 nuk e kanë hapur telefonin.

Kanë mbetur për tu kontaktuar edhe 18,978 aplikues dhe gjithashtu kanë mbetur për tu kontaktuar sërish sipas radhës edhe 17,436 aplikues, që në total bëjnë gjithsejtë: 36,414 aplikues.

Andaj, lidhur me këtë, **Departamenti i Operacioneve Zgjedhore rekomandon që sot të bëhet certifikimi i Listës Përfundimtare të Votuesve, duke përfshirë edhe numrin e votuesve që kanë aplikuar suksesshëm si votues jashtë Kosovës, që në total është: 102,100.** Ndërsa për numrin e mbetur të vazhdohet me verifikimin dhe konfirmimin e 36,414 aplikuesve, deri me datën 06.02.2021.

Nga lista e mbetur nëse aplikuesit nuk e hapin telefonin, ose e konfirmojnë se nuk kanë aplikuar personalisht për të votuar përmes postës, në këtë rast sekretariati nuk do të bëjë vlefshmërinë e pakove me fletëvotime që mund të arrijnë nga këto kategori:

- a) 18,978 që ende nuk janë kontaktuar, ku nga ky grup mund të paraqiten raste që nuk e hapin telefonin, dhe
- b) 17,436 aplikues që janë kontaktuar në herën e parë dhe të dytë, do të kontaktohen sërish me qëllim të verifikimit dhe konfirmimit.